



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 550/3 Prot.

Tiranë, më 12.05.2025

V E N D I M

Nr.119, Datë 12.05. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 72 Regj, datë 27.03.2025, të paraqitur nga ankuesja A.Ç kundër Kuvendit të Shqipërisë, znj. R.Gj , Drejtore, Shërbimi i Protokollit, Kuvendi i Shqipërisë, znj. I.P , Drejtore e Përgjithshme, Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë, Kuvendi i Shqipërisë, z.G.Gj , Sekretar i Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “gjinisë”, “bindjeve politike” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja znj. A.Ç ndër të tjera parashtron se, ka filluar punë pranë Kuvendit të Shqipërisë në një pozicion politik dhe konkretisht në Kabinetin e Nënkretarit të Parlamentit të Partisë Demokratike, z. M.M. Duke qenë se nuk i përket asnjë partie politike, pas disa muajsh ka kërkuar që të kontribuonte në administratën e Kuvendit të Shqipërisë. Meqënëse vinte nga një eksperiencë e gjatë në media kaloi si specialiste në Sektorin e Medias dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe më pas specialiste për Protokollin, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë, Sektori i Protokollit.

Gjatë viteve 2019-2023 ka punuar në Kuvendin e Shqipërisë në tre pozicionet e lartpërmendura. Viti i parë, i dytë dhe i tretë kanë qenë të qeta dhe gjatë kësaj periudhe ka punuar me drejtoreshë M.A dhe J. D, me të cilat ka patur marrëdhënie korrekte dhe frytdhënëse. Problemi sipas ankuses

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

ka nisur kur ka filluar punë si specialiste për Protokollin, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe drejtoreshë R.Gj .

Pas dy vitesh në këtë drejtori, lirohet një vend pune i lënë pezull nga kolegu E.D, që automatikisht sipas Ligjit të Statusit të Nëpunësit Civil, ky vend pune, para të interesuarve nga jashtë i jepet prioritet nëpunësit që ka kontribuar prej dy vitesh. Ky vend nuk shpallej vakant edhe pse zëvendësuesja ishte aty prej dy vitesh, duke e spostuar ankuesen tek Drejtoria e Botimeve, vend të cilin e ka refuzuar. Ky vend u hap vetëm në momentin që fituesi ishte paracaktuar me përkrahje politike, ndërkohë që ankuesja gjatë gjithë kësaj kohe dhe deri sa është larguar është parë si prurje e Partisë Demokratike, pavarësisht se nuk është anëtare, mbështetëse apo simpatizante e ndonjë force politike. Pra ata që do partia në pushtet mund të punësohen, mund të ngrihen në detyrë, duke diskriminuar hapur punonjësit e administratës.

Pas aplikimit për pozicionin e shpallur vakat për Specialiste tek Protokolli, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, ankuesja konkuron dhe fiton këtë pozicion. Drejtoresha e saj znj. R.Gj , e ka pritur me këmbët e para dhe nuk e dëshironte në drejtori. Në fakt ajo nuk dëshironte asnjë grua në atë drejtori, pasi kërkonte të gjithë vëmendjen dhe kishte frikë se mos gratë i zinin vendin e punës. Kjo vinte nga mosbesimi që ajo kishte me veten. Ishte e panikosur gjatë gjithë kohës, pasi ajo ishte vendosur në atë drejtori pa konkurs, ishte emëruar. Ankuesja ishte e padëshiruar në këtë drejtori dhe pyetej se përse nuk kishte vijuar tek Marrëdhëniet me Median. Sapo ankuesja filloi punë në Sektorin e Protokollit, pozicioni në Sektorin e Medias hapet dhe shpallet fituesi. Diskriminim total. Pas dy viteve në Sektorin e Medias, iu bë e qartë se do të ishte sërish në provë, do të ndiqte provimin e Aspës dhe do të vijonte punën.

Gjatë një viti punë, ankuesja shprehet se është ndeshur me dhunë verbale nga drejtoresha e saj znj. Gj. , e cila shprehej herë pas here se ajo ishte e padëshiruar jo vetëm prej saj por dhe titullarët më lart. Drejtoresha thërriste në zyrë vartësen më të vjetër dhe e instruktonte si të sillej me vartësit e rinj. Ata që kishin përkrahje politike do të mirëpriteshin, në të kundërt sulm dhe dëbim nga puna. Diskriminuese shumë edhe kjo.

Plotë pesë punonjës janë larguar para ankueses nga Kuvendi i Shqipërisë prej R.Gj, E.S, E.P, F. D, S.V, N.H, Z. K. (emërime dhe largime të cilat gjenden në Kuvendin e Shqipërisë. Një sektor që nuk kishte qëndrim dhe qetësi, por luftë dhe largime nga puna. Të gjitha këto në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm z. G.Gj , që e përkrahte, e mbështeste dhe e shtynte në vendimmarrje, dhe në komplot me njëri tjetrin ku merreshin vesh shumë mirë, përfshirë zonjat I.P , Drejtoresha e Përgjithshme dhe M.F, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore). “Kurbani” i fundit ishte ankuesja, edhe pse me rrogën më të ulët, ku ka bërë njëkohësisht punën e specialistes, punën e drejtoreshës dhe këshilltares, pasi mungonin si t’ua kishte ënda, se ishin më të vjetra, me 10 vjet eksperiencë aty.

Ankuesja pretendon se është ndeshur me një diskriminim të madh, ndryshe nga punonjësit e tjerë të cilët kishin të drejta minimaliste. Ajo është ndeshur me një gjuhë fyese, bullizuese, arrogancë, përndjekje gjatë gjithë orarit të punës, gjë që vijonte dhe në orët e vona pas mbarimit të orarit zyrtar,

deri dhe në orët e vona të mbrëmjeve apo mëngjeseve herët, ku drejtoresha fyente e kërcënonte se ajo nuk do të qëndronte në atë institucion sepse askush nuk e donte. Ankuesja nuk do ta merrte kurrë Statusin e Nëpunësit Civil (paramendim).

Ankueses i thuhej se, ajo duhet të merrej me median pasi nuk ishte e denjë për atë institucion dhe se duhet të jepte dorëheqjen. Ajo e merrte rrogën kot (fyerje, diskriminim), ishte e padëshiruar, ishte e paafte dhe duhet të lironte vendin e punës.

Sipas ankueses, ajo nuk ishte në punë për të dashur apo për të adhuruar drejtoreshën por për të bërë punën dhe akuzohej se bënte thashetheme për drejtoreshën, akuza korridore të rëndomta. Të gjitha këto i janë thënë në mënyrë verbale në zyrën e drejtoreshës, por edhe të dokumentuara me mesazhe dhe emaille zyrtare, kërcënuese, denigruese kolektive.

E njëjta situatë përsëritej çdo ditë, stres, dhunë, debate të kota, akuza të rëndomta. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me dy kolege të tjera N.H e cila dha dorëheqjen, pasi nuk mund të duronte stresin dhe dhunën nga drejtuesja Gj. . Madje drejtoresha Gj. , shumë arrogante, herë pas herë ka përfunduar në dhunë verbale me punonjëset. Kulmi i kulmit të përdorësh dhunë grua me grua, ndërkohë që gjithnjë e më tepër flitet për mbrojtje dhe diskriminim të grave në ato korridore. Sipas ankueses, H. një ditë u largua nga puna në gjendje të rënduar dhe u ankua tek Sekretari i Përgjithshëm, por më kot. Gj. nuk tundej nga vendi i saj. Ishte e paprekshme. Znj. F., shprehej se e kishin drejtoreshën më shembullore. U ankua gjithandej dhe nuk gjeti zgjidhje.

Në këto kushte ankuesja shprehet se i është dashur të bënte punën e saj, punën e lënë nga kolegja H., punën e znj. Gj. , pasi kjo e fundit ishte e zënë me punë private, udhëtime personale, koncerte dhe festivale, pasi këndonte, ushtronte edhe profesionin e këngëtares, duke lënë barrën e punëve të saj. Më shumë nuk vinte se vinte, pushonte sa herë ndihej e lodhur. (Diskriminuese) Znj. Gj. vijoi të njëjtën gjuhë diskriminuese dhe sfiduese për këdo vartës që i dilte përpara. Pas një viti punë me stres, me debate, me dhunë verbale dhe me ofendime, ku nuk munguan dhe vërejtjet për vartësit. Puna vijonte mrekullisht, kur znj. Gj. të ngarkonte punë bëhej shumë komunikuese, normale, duke t'u lutur, a mund ta bësh këtë dhe atë.....

Ankuesja parashtroi se, pasi është ankuar disa herë tek eprorët e saj për këtë sjellje aspak normale, duke kundërshtuar vërejtjet me shkrim dhe sjelljen e drejtoreshës, shpesh herë i jepej të drejtë znj. Gj. .E kotë gjithçka, komplot dhe e kopsitur si situatë. Në këto kushte ankueses i është dashur edhe të ndiqte programin e Aspa-s, ku ka marrë vlerësim maksimal. Drejtoresha në vend që ta linte të qetë, sipas ligjit mos ta ngarkonte me punë, jo vetëm që e përfshinte, por e stresonte, i ulëriste duke i thënë që atë provim nuk do ta merrte kurrë, duke e demotivuar dhe stresuar, dhe që nuk do të qëndronte në punë në atë institucion. Këto sjellje i bënte sipas ankueses jo vetëm me atë por edhe me dy kolege të tjera N.H dhe E.G, kjo e fundit u largua menjëherë pas ankueses.

Në këto kushte, pa përfunduar vitin e provës, në sektorin ku punonte ankuesja vijnë dy specialistë të rinj, gjë kjo e paramenduar dhe e paracaktuar me kohë, pasi organika nuk lejonte më shumë se tre vartës. E gjendur në këto kushte, ankuesja deklaroi se ka kërkuar takim me drejtoreshën e madhe

znj.I.P dhe Sekretarin e Përgjithshëm z. G.Gj , duke kërkuar fshirjen e vërejtjeve, të cilat nuk qëndronin si dhe që znj. Gj. të mos ndikonte në marrjen e Statusit të Nëpunësit Civil, apo që vlerësimi të mos bëhej nga një drejtoreshë që kishte konflikt të hapur. Ankuesja shprehet se nuk mori asnjëherë përgjigje apo zgjidhje. Fill pas një viti ndodhi ajo që pritej duke mos e marrë konfirmimin për Statusin e Nëpunësit Civil, pas një muaji që kishte kaluar viti i provës, pasi kishte dorëzuar edhe një raport mjekësor dy javor. Absurde. Diskriminuese.

Ankuesja deklaroi se, në lidhje me largimin nga puna ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe çështja është duke u shqyrtuar në këtë gjykatë.

Ankuesja ka përcaktuar në formularin e ankesës të depozituar pranë Komisionerit se, subjekti i cili ka kryer diskriminimin ndaj saj është *“Kuvendi i shqipërisë, nëpërmjet punonjësve të tij”*.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri:

- Marrjen e Statusit të Nëpunësit Civil, pagesat dhe rikthimin në vendin e punës.
- Pezullimin nga puna të drejtoreshës konfliktuale znj. R.Gj , derisa të zgjidhet kjo çështje dhe hetimi i gjendjes së saj shëndetësore dhe emocionale.
- Hetimi i rasteve se përse specialistet femra nuk mund të qëndrojnë në atë sektor.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkuftizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

1. Me *emailin* e datës 10.04.2025, ankueses iu kërkuar plotësimi i ankesës, sa i përket saktësimi të subjekteve kundër të cilëve drejtohet ankesa si shkakut të pretenduar të diskriminimit në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”. Ankueses iu kërkuar gjithashtu të depozitonte kopje të kërkesë padisë të depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim vlerësimin nëse Komisioneri ndodhet në kushtet e pamundësisë për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, sipas përcaktimeve të pikës 7/4, të nenit 33, të LMD, ku përcaktohet: “7/4. Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”

1.1 Ankuesja ktheu përgjigje nëpërmjet *emailit* të datës 12.04.2025, duke parashtruar se:

Në lidhje me saktësimin e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, ankuesja saktësoi se, ankesa e saj drejtohet kundër institucionit të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe kundër ish eprores znj. R.Gj , Drejtore, Shërbimi i Protokollit, Kuvendi i Shqipërisë, e cila shkakton polemika gjatë gjithë kohës, nxit stres urrejtje, ofendon dhe intimidon, znj. I.P , Drejtore e Përgjithshme, Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë, Kuvendi i Shqipërisë, e cila nuk vepron për zgjidhjen e situatave dhe nuk e kundërshton vartësen e saj znj. Gj. në asnjë moment, si dhe z. G.Gj , Sekretar i Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë, që nuk zgjidh problematikat dhe në fund bëhen bashkë dhe me një mendim të paracaktuar vendosin që ankuesja të mos konfirmohet si nëpunëse civile.

Në lidhje me saktësimin e shkakut të pretenduar të diskriminimit në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”, ndër të tjera ankuesja parashtroi: “.....Diskriminimi ndihet kur eprorja ime znj.Gj. më drejtohet me emaile të cilat jua kam nisur. Dërgon emaile kolektive duke më intimiduar, duke të ofenduar dhe duke të kërkuar dorëheqjen. Gjuha e përdorur nga një punonjëse e fortë si znj. Gj. (që gjen përkrahje nga eprorët) duke përdorur me vartësit e pambrojtur, duke lëshuar vërejtje me shkrim për situata që krijojnë vet, e duke i paraprirë Ok të Statusit të Nëpunësit Civil, duke më ngarkuar punën si në kushte normale (kjo vërehet nga disa emaile që puna vijon normalisht dhe në asnjë sms email nuk kundërshtohet) duke intimiduar punonjësin, duke ofenduar dhe duke kërkuar dorëheqjen jo vetëm në formën verbale por dhe në formë institucionale, emaile zyrtare dhe sms”.

1.2 Me *emailin* e datës 14.04.2025, ankuesja depozitoi një kopje të kërkesë padisë, por dokumenti i dërguar, nuk ishte në formën e kërkuar dhe nuk provonte se ishte kopje e kërkesë padisë së depozituar në gjykatë.

2. Me shkresën nr.550/1 prot, datë 22.04.2025, Komisioneri iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me qëllim administrimin e kopjes së padisë që ankuesja ka depozituar pranë kësaj gjykate. Me shkresën nr.7363/1 prot datë 25.04.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë pranë Komisionerit u administrua kopja e kërkesë padisë.

3. Bazuar në parashtrimet e ankueses dhe dokumentacionin e administruar, konstatohet se:

Ankuesja A.Ç ka qenë në marrëdhënie pune pune pranë Kuvendit të Shqipërisë, në pozicionin Specialiste në Shërbimin e Protokollit. Marrëdhëniet e saj të punës në këtë pozicion kanë filluar më datë 25.03.2022, fakt ky që rezulton i provuar sipas Librezës së Punës.

Referuar Librezës së Punës, konstatohet se ankuesja ka filluar punë pranë Kuvendit të Shqipërisë më datë 22.05.2019, në pozicionin “Sekretare e Nënkyetarit” dhe është liruar nga kjo detyrë më datë 11.02.2020 për të kaluar në një tjetër pozicion pune brenda këtij institucioni dhe konkretisht në pozicionin “Specialist i jashtëm në Sh.Komunikimit”. Ankuesja ka punuar në pozicionin “Specialist i jashtëm në Sh.Komunikimit” deri më datën 31.12.2021, datë në të cilën është liruar nga detyra, fakt ky që rezulton i provuar sipas Librezës së Punës.

Ankuesja është rikthyer të punojë pranë Kuvendit të Shqipërisë më datë 25.03.2022, datë në të cilën është punësuar në pozicionin “*Specialiste në Shërbimin e Protokollit*”. Në përfundim të periudhës së provës, me vendimin nr.905/3 datë 05.04.2023, të eprorit direkt znj. R.Gj , ankuesja nuk është konfirmuar si nëpunëse civile. Ankuesja nuk ka qenë dakort me këtë vendim dhe më datë 11.04.2023 e ka ankimuar. Në lidhje me këtë ankim të ankueses, Kuvendi i Shqipërisë ka disponuar me vendimin nr. 905/5 datë 14.04.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm, nëpërmjet të cilit ka lënë në fuqi vendimin e eprores direkte znj. R.Gj , nr. 905/3 datë 05.04.2023 “*Për moskonfirmimin e nëpunësit znj.A.Ç*”. Referuar Librezës së Punës, marrëdhënia e punës ka përfunduar më datë 20.04.2023.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 72, datë 27.03.2025, duke pretenduar se është diskriminuar nga Kuvendi i Shqipërisë; znj. R.Gj , Drejtore, Shërbimi i Protokollit, Kuvendi i Shqipërisë; znj. I.P , Drejtore e Përgjithshme, Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë, Kuvendi i Shqipërisë; dhe, z. G.Gj , Sekretar i Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjinisë*”, “*bindjeve politike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

4. Nga shqyrtimi i kërkesë padisë së paraqitur nga pala ankuese, të vendosur në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, konstatohet se nuk ekzistojnë kushtet e pamundësisë për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionerit, sipas përcaktimeve të pikës 7/4, të nenit 33, të LMD, pasi *kërkesë padia e paraqitur nga pala ankuese në gjykatë nuk është me objekt konstatim diskriminimi.*
5. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. *Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;*” Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: “1. *Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.* 2. *Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht*

për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlijet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlijjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk

ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet³. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁴. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁵.

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme⁶.

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma (neni 3, LMD), ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2 LMD) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7, LMD).

LMD, përcakton dhe rregullon edhe rastet kur diskriminimi, është rezultat i ndërveprimit të dy ose më shumë shkaqeve, duke përcaktuar në pikat 3 dhe 5 të tij, si vijon: “ 3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë

³ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁴ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁵ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, *Dhoma e Madhe*, datë 14.05.2016, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Dhoma e Madhe* 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

⁶ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

forma të veçanta të diskriminimit. 5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas. “

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Referuar parashtrimeve dhe pretendimeve të ankuses, ajo pretendon se sjellja diskriminuese për të cilën ka paraqitur ankesën para Komisionerit, ka më shumë se një shkak dhe konkretisht *bindjet politike, gjininë dhe “çdo shkak tjetër”*. Gjithashtu, shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesja duke ju referuar parashtrimeve të bërë nga ana e saj, pretendohen kundërt të gjithë subjektet kundër të cilëve ankuesja ka paraqitur ankesën: znj. R.Gj , Drejtore, Shërbimi i Protokollit, Kuvendi i Shqipërisë, znj. I.P , Drejtore e Përgjithshme, Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë, Kuvendi i Shqipërisë dhe z. G.Gj , Sekretar i Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë.

Në lidhje me shkakun e *bindjeve politike dhe gjinisë*, Komisioneri konstaton se të dy këto shkaqe janë shkaqe që gëzojnë mbrojtje në mënyrë të shprehur, sipas nenit 1, të LMD. Në lidhje me

ekzistencën dhe provueshmërinë e tyre si shkaqe diskriminuese në bazë të fakteve dhe rrethanave të parashtruara nga pala ankuese, Komisioneri vlerëson se:

Sa i përket shkakut të bindjeve politike, ankuesja pretendon se, sjellja diskriminuese e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën bazohet në shkakun e bindjeve politike, pasi ajo konsiderohet prej tyre si “*prurje e Partisë Demokratike*” për shkak se fillimisht ka filluar punë në një pozicion politik, pranë Kabinetit të Nënkrjetarit të Parlamentit të Partisë Demokratike, z. Myslim Murrizi, pavarësisht se ankuesja deklaron se nuk është anëtare, mbështetëse apo simpatizante e ndonjë force politike. Sipas ankuses, ata që do partia në pushtet mund të punësohen, mund të ngrihen në detyrë, duke diskriminuar hapur punonjësit e administratës dhe se, ata që kanë përkrahje politike mirëpriten, në të kundërt sulm dhe dëbim nga puna.

Referuar provave të depozituara nga pala ankuese, rezulton se ankuesja ka punuar pranë Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 22 maj 2019 deri më 11 shkurt 2020, në pozicionin “*Sekretare e Nënkrjetarit*”, por pa të dhëna dhe informacione të tjera në lidhje me faktin e pretenduar nga ankuesja se ka qenë sekretare e Nënkrjetarit të Kuvendit të Partisë Demokratike z. M., që do të përlligjte edhe pretendimin në lidhje me shkakun e pretenduar të bindjeve politike.

Prezumimi për përkatësinë e saj politike, nëse do të marrim të mirëqënë faktin se ankuesja ka filluar punë në Kabinetin e Nënkrjetarit të Kuvendit të Partisë Demokratike, z. M., fakt ky që nga dokumentacioni i depozituar nuk rezulton i provuar, përkatësia politike e prezumuar e ankuses ka qenë e njohur që në momentin që ankuesja ka filluar marrëdhënien e punësimit pranë Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2019, dhe pavarësisht këtij fakti, ankuesja ka vijuar marrëdhënien e punësimit me Kuvendin në pozicione të tjera pune. Nëse ankuesja është prezumuar si “*prurje e Partisë Demokratike*” dhe pretendon se, vetëm ata që do partia në pushtet mund të punësohen, kjo nuk mbështet pretendimet e ankuses. Nga ana tjetër, shkakun i bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesja, i cili konsiston në prezumimin sipas saj si “*prurje e Partisë Demokratike*”, nuk rezulton që të ketë ndikuar në marrëdhënien e saj të punësimit pranë Kuvendit të Shqipërisë, pasi ankuesja shprehet se, marrëdhënia e saj e punës ka ecurar e qetë dhe normalisht kur ajo ka punuar në sektorë dhe me eprore të tjera. Pra, nëse bindjet politike do të përbënin një shkak të prezumuar diskriminimi, si pasojë se ankuesja është konsideruar si “*prurje e Partisë Demokratike*”, kjo do të kishte ndikuar edhe më parë në ecurinë e marrëdhënies së punës së ankuses në pozicionet e tjera të punës që ajo ka mbajtur pranë Kuvendit të Shqipërisë

Ankuesja deklaron në ankesë se, problematika e saj ka nisur sapo ajo ka filluar punë si “Specialiste për Protokollin” në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë, me Drejtoreshë R.Gj . Nëse do të vijonim logjikën e parashtruar nga vetë ankuesja, konsiderimi i ankuses si “*prurje e Partisë Demokratike*” nuk do të kishte ndikuar në ecurinë e marrëdhënies së saj të punës pranë punëdhënësit/Kuvendit të Shqipërisë, nëse ankuesja nuk do të kishte eprore direkte znj.R.Gj . Në këtë kuptim, prezumimi në lidhje me bindjet dhe përkatësinë politike të ankuses, haptazi nuk duket se ka shërbyer si shkak për sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ankuesja, pasi vetë ankuesja

deklaron se trajtimi diskriminues është drejtpërdrejtë i lidhur me eproren e saj direkte znj.R.Gj dhe marrëdhënien që ka ekzistuar midis tyre. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve politike, është haptazi i pabazuar.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjinisë, ndër të tjera ankuesja parashtroi: *“....Drejtoresha ime, R.Gj më priti me këmbët e para. Nuk më dëshironte në atë drejtori, pasi kërkonte të gjithë vëmendjen dhe kishte frikë se mos gratë i zinin vendin e punës. Kjo vinte nga mosbesimi që ajo kishte për veten. Ishte e panikosur gjatë gjithë kohës, pasi ajo ishte vendosur në atë drejtori pa konkurs, ishte emëruar. Unë nuk isha e dëshiruar në atë drejtori dhe më pyeste përse nuk vijova tek Marrëdhëniet me Median.....”*.

Në kuptim të LMD dhe referuar nenit 1 dhe nenit 3, pika 1, të tij, diskriminimi për shkak të gjinisë, është: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjini, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në referim të nenit 4, pika 3, të ligjit nr. Nr.9970, datë 24.7.2008 *“Për Barazinë Gjinore në Shqetësi”, “Diskriminim për shkak të gjinisë” është: çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.”*

Sipas ankueses, ajo është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e eprores së saj znj.Gj. , nga frika e kësaj të fundit për zënien e vendit të punës nga gratë dhe, rrjedhimisht edhe nga ankuesja.

Komisioneri konstaton se, pretendimet e paraqitura nga ankuesja nuk kanë të bëjnë me diferencë në trajtim ose dështim për të trajtuar ndryshe ankuesen për shkak të gjinisë. Në baza të fakteve dhe rrethanave të parashtruara Komisioneri vlerëson se nuk jemi në kushtet e ndonjë trajtimi të diferencuar dhe të pafavorshëm për shkak të gjinisë, dhe rrjedhimisht të ankueses për shkak se është grua krahasimisht me persona/punonjës të tjerë burra. Referuar pretendimeve të ankueses në lidhje me shakun e pretenduar të diskriminimit, gjininë, Komisioneri e gjen haptazi të pabazuar.

Në lidhje me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, ankuesja ka identifikuar në formularin e ankeses edhe *“çdo shkak tjetër”*, por pa identifikuar dhe saktësuar shkakun e pretenduar në kuadër të këtij përcaktimi.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes *“për çdo shkak tjetër”*. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi *“çdo shkak tjetër”* përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit *“çdo shkak tjetër”* mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të

tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkaku i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.⁷

Referuar emailit të datës 12.04.2025, në lidhje me saktësimin e shkakut të pretenduar të diskriminimit në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, ndër të tjera ankuesja parashtroi: “.....Diskriminimi ndihet kur eprorja ime znj. Gj. më drejtohet me emaile të cilat jua kam nisur. Dërgon emaile kolektive duke më intimiduar, duke të ofenduar dhe duke të kërkuar dorëheqjen. Gjuha e përdorur nga një punonjëse e fortë si znj. Gj. (që gjen përkrahje nga eprorët) duke përdorur me vartësit e pambrojtur, duke lëshuar vërejtje me shkrim për situata që krijon vet, e duke i paraprirë Ok të Statusit të Nëpunësit Civil, duke më ngarkuar punën si në kushte normale (kjo vërehet nga disa emaile që puna vijon normalisht dhe në asnjë sms email nuk kundërshtohet) duke intimiduar punonjësin, duke ofenduar dhe duke kërkuar dorëheqjen jo vetëm në formën verbale por dhe në formë institucionale, emaile zyrtare dhe sms”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja nuk identifikon asnjë karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status që mund të prezumohet se ka shërbyer për sjelljen e pretenduar si diskriminuese. Të gjitha sa më sipër parashtrohen nga ankuesja janë elementë dhe aspekte të sjelljeve diskriminuese, pra të trajtimit të disfavorshëm, të pretenduara nga ankuesja, por jo shkaku pretenduar i diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri e gjen haptazi të pabazuar pretendimin e ankueses referuar shkakun të pretenduar të diskriminimit në kuadër të termit “çdo shkak tjetër” .

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr.72 datë 27.03.2025, e paraqitur nga ankuesja A.Ç , nuk mund të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁷ Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë, prg. 90.

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.72, datë 27.03.2025, të paraqitur nga ankuesja znj.A.Ç , pasi nuk plotësohen kushtet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku:	“gjinisë”, “bindjeve politike” dhe “çdo shkak tjetër”
Fusha:	Punësim
Lloji i vendimit:	Mospranim